

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E TË ARDHURAVE, BASHKIA SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, me objekt “Mbi realizimin e të ardhurave vendore dhe zbatimin e legjislacionit për programimin dhe vjeljen e taksave vendore” për periudhën nga data 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 112, datë 12.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 577/7, datë 12.09.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Lorenc Luka, Kryetar i Bashkisë, Shkodër.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Për një pjesë të subjekteve të regjistruara në Drejtorinë e të Ardhurave nuk është bërë dërgimi i njoftim detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për 34 subjekte për vitin 2011, për 51 subjekte për vitin 2012 dhe 87 subjekte për vitin 2013, ***sa më sipër rekomandojmë:***

Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër t’u dërgojë në rrugë postare, njoftimet e detyrimeve për subjektet që kanë detyrimin ligjor për të paguar taksa dhe tarifa vendore dhe të sigurojë konfirmimin për mbërritjen e njoftimit për detyrimin e llogaritur për çdo vit në vazhdim.

2. Për vitin 2011 nuk janë dërguar njoftimet për taksat familjare, gjë që është bërë në vijim për vitin 2012 dhe 2013 me anë të agentit tatimor Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizime sha, Shkodër, *trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit faqe 27 deri 29, sa më sipër rekomandojmë:*

Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me agentin tatimor Ndërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizime sha, Shkodër, të lidhin akt marrëveshje për arkëtimin e diferencës së pa arkëtuar në vlerën **4,961 mijë lekë** për taksat dhe tarifat familjare të vitit 2011.

3. Nga Sektori i Kontrollit Tatimor në Drejtorinë e të Ardhurave, Bashkia Shkodër janë ushtruar kryesisht kontrole verifikuese të adresave në bazë të ndarjeve territoriale dhe nuk janë kryer kontrole të natyrave të tjera të bazuar në metodat e përzgjedhjes me risk të subjekteve. Nga Sektori i Verifikimit në Terren nuk ka plane pune, vjetore dhe mujore, ***sa më sipër rekomandojmë:***

Të merren masa nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, që nga Sektori i Kontrollit Tatimor të hartohen plane pune vjetore dhe mujore të miratuara nga Drejtori i Drejtorisë në bashkëpunim me Përgjegjësën e Sektorit, si dhe të përdoret metoda e përzgjedhjes me risk e subjekteve që do të kontrollohen.

Të merren masa nga Drejtoria e të Ardhurave, Sektori i Kontrollit që të ushtrohet kontroll në subjekte për llogaritjen e detyrimeve tatimore, mbajtjen e regjistrave dhe kryerjen e pagesave të tatimeve në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin tatimor.

4. Nga Drejtoria e të Ardhurave, Sektori i Masave Shtrënguese nuk janë aplikuar masat shtrënguese që parashikon ligji në përputhje me moshën e borxhit, ***sa më sipër rekomandojmë:***
Nga Drejtoria e të Ardhurave, Sektori i Masave Shtrënguese për të gjithë subjektet me borxh të vjetër dhe pa masë, të merren masat shtrënguese të parashikuara në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH”.

5. Nga Sektori i Regjistrimit dhe Vlersimit nuk janë përpiluar dosje të tatimpaguesve me të dhëna të përditësuara. Dosjet janë pa inventar dhe pa kronologji veprimesh, ***sa më sipër rekomandojmë:***

Të merren masa për plotësimin, përditësimin dhe inventarizimin e dosjeve të subjekteve të regjistruara nga Sektori i Regjistrimit dhe Vlersimit, Bashkia Shkodër, në bazë të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore” me ndryshimet nenet 5, 35, dhe ligjit 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin e Funksionimin e Qeverisjes Vendore” si dhe ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Shkodër, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për arkëtimin e detyrimeve për vlerën **13,539,085 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Të bëhet llogaritja dhe arkëtimi i vlerës **prej 2,704,087 lekë** nga **34 subjekte** sipas pasqyrës nr.1 viti 2011, përkatësisht për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave në vlerë 1,455,000 lekë, për taksën e tabelës për qëllime identifikimi në vlerë 4,320 lekë, për taksën mbi ndërtesat në vlerë 321,950 lekë, për tarifën e gjelbërimit në vlerë 235,000 lekë, për tarifën e ndriçimit në vlerë 147,000 lekë, për gjobat e llogaritura mbi për detyrimet e pa paguara në afat në vlerën 540,817 lekë, detyrime të vitit 2011.

2. Të bëhet llogaritja dhe arkëtimi i vlerës **prej 3,685,408 lekë** nga **51 subjekte** sipas pasqyrës nr. 2 viti 2012, përkatësisht për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave në vlerë 2,012,018 lekë, për taksën e tabelës për qëllime identifikimi në vlerë 5,830 lekë, për taksën mbi ndërtesat në vlerë 413,904 lekë, për tarifën e gjelbërimit në vlerë 319,248 lekë, për tarifën e ndriçimit në vlerë 197,330 lekë, për gjobat e llogaritura mbi për detyrimet e pa paguara në afat në vlerën 737,078 lekë, detyrime të vitit 2012.

3. Të bëhet llogaritja dhe arkëtimi i vlerës **prej 5,922,552 lekë** nga **87 subjekte** sipas pasqyrës nr.3 viti 2013, përkatësisht për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave në vlerë 3,207,914 lekë, për taksën e tabelës për qëllime identifikimi në vlerë 9,950 lekë, për taksën mbi ndërtesat në vlerë 683,106 lekë, për tarifën e gjelbërimit në vlerë 502,414 lekë, për tarifën e ndriçimit në

vlerë 334,663 lekë, për gjokat e llogaritura mbi për detyrimet e pa papaguara në afat në vlerën 1,184,505 lekë, detyrime të vitit 2013.

4. Të bëhet llogaritja dhe arkëtimi i vlerës **prej 300,000 lekë nga 3 subjekte** për mosarkëtimin e tarifës prej 100,000 lekë për çdo autorizim të subjekteve që tregton karburant me shumicë dhe pakicë.

5. Të bëhet llogaritja dhe arkëtimi i vlerës **prej 435,800 lekë nga 8 subjekte** për taksën e tabelës për qëllime reklamimi.

6. Të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **400,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative për **16 subjektet** dhe rastet e përshkruara në aneksin 5.

7. Të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **91,238 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative për **2 (dy) subjektet** e crregjistruara nga QKR-ja duke pasur detyrime të taksave vendore.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Shkodër, që në vlerësimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda e shumë të rënda, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin e dhënien e masave përkatëse disiplinore nga “vërejtje” deri në “largim nga detyra”, sipas VKM nr. 115, datë 5.3.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, **për 8 punonjës**, të Drejtorisë së të Ardhurave, Bashkia Shkodër, si më poshtë:

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë ish Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe të Rekuperimit me Forcë në Drejtorinë e të Ardhurave.

2. Për [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe të Rekuperimit me Forcë në Drejtorinë e të Ardhurave, pasi:

-Nuk kanë marrë masat e nevojshme për mbledhjen dhe rekuperimin e borxhit bazuar në Ligjin nr 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

-Nuk kanë bërë aplikimin e përzgjedhjes me risk për kontrollin e subjekteve, kërkesë e ligjit 9920, dt.19.05.2008“Për Procedurat Tatimore në RSH”.

-Nuk kanë kryer kontrole me tematikë për rivlerësimin e detyrimeve, përdorimin e kasës etj, por kryesisht kontrole të tipit verifikues të adresave të ushtrimit të aktivitetit të subjekteve.

-Nuk ka bërë penalizimin e subjekteve me nga 25,000 lekë, bazuar në ligjin nr. 9920, dt. 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", neni 43, pika 1 dhe 2, neni 112, në rastet e përshkruara në aneksin 5.

3. Për [REDAKTUAR] me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave pasi:

- Nuk ka kërkuar nga Sektori i Regjistrimit përpilimin dhe përditësimin e dosjeve të subjekteve, nuk ka marrë masat e nevojshme për mbledhjen dhe rekuperim e borxhit konform rregullimeve të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH".
- Nuk ka kërkuar nga Sektori i Kontrollit dhe i Masave Shtreënguese aplikimin e metodave të riskut në përzgjedhjen e subjekteve për auditim, si dhe kryerjen e kontrolleve në subjektet tatimpaguese me tematikë rivlerësimin e detyrimeve dhe zbatimin e legjislacionit tatimor.
- Për mosinicimin e detyrimeve me nga 100,000 lekë për çdo autorizim për tregtimin e karburanteve, trajtuar në procesverbalin numër 1 dhe datë 15.07.2014.
- Për moslidhjen e kontratës me agentët tatimor në vitin 2011, për të kërkuar gjenerimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat familjare me vlerë 4.961 mijë lekë.

4. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit, pasi:

- Nuk ka përpiluar dhe përditësuar dosjet e subjekteve konform rregullimeve të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore" me ndryshimet nenet 5, 35, dhe ligjit 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin e Funksionimin e Qeverisjes Vendore" si dhe ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".
- Për mos zbatim të procedurave në dërgimin e detyrimeve ndaj subjekteve të Drejtorisë së të Ardhurave, Bashkia Shkodër, për detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për 34 subjekte për vitin 2011, për 51 subjekte për vitin 2012 dhe 87 subjekte për vitin 2013.
- Për mosndjekje të procedurave ligjore për kërkimin e detyrimeve të papaguara, për dy subjekte që janë çregjistruar në QKR dhe për të cilat Drejtoria e të Ardhurave nuk është vënë në dijeni.

5. [REDAKTUAR] me detyrë inspektor kontrollit dhe masave shtrënguese në Sektorin e Kontrollit dhe të Rekuperimit me Forcë në Drejtorinë e të Ardhurave, Bashkia Shkodër.

6. [REDAKTUAR] me detyrë inspektor kontrollit dhe masave shtrënguese në Sektorin e Kontrollit dhe të Rekuperimit me Forcë në Drejtorinë e të Ardhurave, Bashkia Shkodër.

7. [REDAKTUAR] me detyrë inspektor kontrollit dhe masave shtrënguese në Sektorin e Kontrollit dhe të Rekuperimit me Forcë në Drejtorinë e të Ardhurave, Bashkia Shkodër.

8. [REDAKTUAR] me detyrë inspektor kontrollit dhe masave shtrënguese në Sektorin e Kontrollit dhe të Rekuperimit me Forcë në Drejtorinë e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, pasi:

- Nuk kanë marrë masat shtrënguese të nevojshme për mbledhjen dhe rekuperimin e borxhit bazuar në Ligjin nr 9920 dt 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH".
- Nuk ka bërë penalizimin e subjekteve me nga 25,000 lekë për 5 raste, bazuar në ligjin nr. 9920, dt 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", neni 43, pika 1 dhe 2, neni 112, në rastet e përshkruara në aneksin 5.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Edvin Stefani, p/grupi, Hekuran Avdulaj, Hodo Hasani, më tej u shqyrtua nga Kryeauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

DPTTV, Bashkia Shkodër me shkresën nr. 577/8, datë 8.10.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve nga ku rezulton se ka dalë Urdhër i Brendshëm i Kryetarit të Bashkisë me nr. 202, datë 1.10.2014 “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH”, ku janë vlerësuar masat organizative dhe masat për shpërblim dëmi të propozuara dhe kanë kaluar për zbatim departamenteve përkatëse të Bashkisë Shkodër. Gjithashtu është dhënë mase disiplinore “vëretje”, për 8 punonjësit e propozuar.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT